

# **RREGULLAT E ZGJEDHJES DHE TË PUNËS SË BORDIT DREJTUES TË PLATFORMËS PËR EDUKIM QYTETAR TË TË RINJVE PËR LUFTËN KUNDËR RADIKALIZIMIT**

## **Fushëveprimi/Kompetencat e BD**

Bordi Drejtues i Platformës për edukim qytetar të të rinjve për luftën kundër radikalizimit ka këto përgjegjësi:

- Të ofrojë drejtime strategjike për zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Platformës.
- Të monitorojë zbatimin e punës së Platformës dhe të vlerësojë progresin
- Të mbështesë ekipin e projektit në planifikimin dhe hartimin e aktiviteteve dhe zgjidhjen e problemeve në kuadër të Platformës.
- Të japë propozime për anëtarët e rinj të Platformës dhe pjesëmarrësit në aktivitetet e projektit.
- Të nxisë interesin dhe të promovojë Platformën në mesin e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë lokalë
- Të ndërtojë lidhje dhe të mbajë komunikim me aktorët lokalë, institucionet, shkollat
- Të mbështes proceset e përfaqësimit në emër të Platformës
- Të ofrojë sugjerime për pasurimin e përmbajtjes së Platformës online

## **Përbërja dhe struktura e BD**

BD do të ketë 7 anëtarë, 4 prej të cilëve do të jenë përfaqësues të partnerëve të projektit, kurse 3 anëtarët e tjerë do të përzgjidhen nga anëtarët e Platformës.

Nga anëtarët e tij, BD do të caktojë një Kryesues, si dhe një koordinator për procedurat administrative dhe një koordinator për komunikim.

Kryesuesi i BD është i obliguar t'i thërrasë mbledhjet dhe t'i drejtojë ato. Krahas mbledhjeve të rregullta, kryesuesi thërret edhe mbledhjet e BD me kërkesë të anëtarëve të BD ose kur paraqitet nevoja. Kryesuesi i nënshkruan aktet e miratuara nga BD. Ai/ajo drejton punën dhe veprimet e BD.

Koordinatori për procedura administrative kontribuon në punën efikase administrative dhe mbështet punën e BD, përgatit raporte dhe procesverbale të rregullta për punën e BD. Ai/ajo mban komunikim të rregullt me Kryesuesin e BD dhe ekipin e projektit.

Koordinatori për komunikim është i ngarkuar me organizimin e aktiviteteve të logjistikës dhe komunikimit, në lidhje me koordinimin e komunikimit të përgjithshëm me publikun dhe mediat, organizimin e konferencave për shtyp (nëse është e nevojshme), organizimin e takimeve dhe trajnimeve, koordinimin me ekspertin për Media & PR në kuadër të projektit gjatë menaxhimit të faqes së internetit, platformat e mediave sociale dhe pregaditja e raporteve për komunikimin.

Anëtarët e asociuar të Platformës do të marrin pjesë në takime të BD në baza ad-hoc, në varësi të temave dhe interesave të tyre. Gjithashtu, nëse është e nevojshme, në mbledhjet e BD mund të ftohen për të marrë pjesë herë pas here edhe komunitat, shkollat, grupet lokale dhe palë të tjera të interesuara lokale, varësisht nga nevoja dhe temat e takimeve. Këto grupe të palëve të interesuara, përveç Memorandumeve të bashkëpunimit në kuadër të projektit, do të përfshihen edhe përmes mekanizmave të tjerë në projekt dhe Platformë, në proceset e konsultimit, përmes pyetësorëve online, fokus grupeve, takimeve joformale e të ngjashme.

Pas vitit të parë të funksionimit të BD, dhe në bazë të përvojës gjatë procesit, do të merret një vendim për strukturën dhe funksionin e BD pas përfundimit të projektit. Deri atëherë, do të jetë e nevojshme të shqyrtohet, diskutohet dhe vendoset nëse Platforma do të bëhet një organ ligjor, nëse do të zgjerohet përtej kufijve të vendit, do të përcaktohet numrin e anëtarëve dhe do të rishikohen ambiciet e tyre për zhvillimin dhe promovimin e Platformës.

## **Procedura për përzgjedhjen e anëtarëve të BD nga radhët e anëtarëve të Platformës**

Kandidatët për anëtarë të BD për tre pozitat e parapara për anëtarët mund të propozohen nga organizatat që janë anëtare të Platformës duke propozuar një përfaqësues nga organizata e tyre, pas thirrjes së shpallur më parë për anëtarë të BD.

Thirrja për anëtarët e BD përgatitet dhe shpallet nga ekipi i projektit. Thirrja u dërgohet me e-mail anëtarëve të Platformës me informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve të BD, si dhe një formular që do të duhet të plotësohet nga organizata që propozon një anëtar për BD. Anëtarët aplikojnë me një letër motivimi dhe mbështetje nga organizata përmes një formulari të plotësuar dhe të nënshkruar nga një person i autorizuar i organizatës propozuese. Kandidatët duhet të kenë përvojë pune në sektorin civil, në fushën e rinisë, në luftën kundër proceseve të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Anëtarësimi i mëparshëm në borde drejtuese do të konsiderohet si avantazh.

Zgjedhja e anëtarëve të BD bëhet në mbledhjen e të gjithë anëtarëve të Platformës. Në takim, kandidatët do të kenë mundësinë për një prezantim të shkurtër, pas së cilës votohet në mënyrë anonime nga anëtarët me të drejtë vote. Çdo organizatë – anëtare ka të drejtën e një vote. Nëse dy ose më shumë kandidatë kanë të njëjtin numër votash, vetëm ata kandidatë rivotohen.

## **Të drejtat, detyrimet dhe mandati i anëtarëve të BD**

Anëtarët e BD kanë të drejtë dhe detyrë të marrin pjesë në mbledhjet e BD, të propozojnë pika të rendit të ditës dhe të shprehin lirisht mendimin dhe qëndrimin e tyre në mbledhje.

Anëtarët e BD janë të obliguar t'i lexojnë materialet që u janë dorëzuar dhe të jenë gati për mbledhje.

Anëtari i BD i cili për shkaqe të arsyeshme pengohet të marrë pjesë në mbledhje, është i obliguar që me kohë ta informojë Kryesuesin e BD. Anëtarit të BD i cili dy herë radhazi, pa njoftim paraprak me kohë deri te Kryesuesi i BD, mungon në mbledhjet e BD, anëtarit të BD i pushon mandati.

Mandati i anëtarëve të BD të zgjedhur nga anëtarët e Platformës zgjat një vit pa të drejtë rizgjedhjeje. Deri në përfundimin e projektit, partnerët e projektit, si anëtarë të Platformës, do të jenë anëtarë të përhershëm të BD. Anëtarit të BD mund t'i ndërpritet mandati me kërkesë të tij/saj me shkrim.

## **Thirrja dhe mbajtja e mbledhjeve të BD**

Mbledhjet e BD do të thirren të paktën 3 herë në vit, dhe nëse është e nevojshme edhe më shpesh.

Seancat thirren nga kryesuesi i BD me iniciativën e tij ose me kërkesë të të paktën tre anëtarëve të BD ose anëtarëve të Platformës.

Ftesa për mbledhje dhe agjenda e punës përcaktohen nga Kryesuesi dhe në draft u dërgohen anëtarëve të BD dhe anëtarëve të Platformës, të cilët mund të propozojnë pika shtesë për diskutim. Koordinatori për Procedura Administrative i njofton anëtarët e BD për ditën, vendin dhe orën e mbledhjes. Ftesa për mbledhjen e BD dhe propozimi i rendit të ditës dorëzohen jo më vonë se 5 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e mbledhjes.

Kuorum për punë ka nëse janë të pranishëm të paktën **4 anëtarë** të Bordit (ku të paktën 2 prej tyre janë nga partnerët e projektit).

## **Udhëheqja me mbledhjet e BD dhe vendimmarrja**

Mbledhjet do të drejtohen/facilitohen nga Kryesuesi, përkatësisht në mungesë të tij me marrëveshje ndonjë nga anëtarët e pranishëm të BD.

Gjuha e punës së takimeve do të jetë maqedonishtja, me mundësi përkthimi në shqip të materialeve për punimin e takimeve.

Çdo person i pranishëm në mbledhje ka të drejtë të diskutojë. Të drejtë vote kanë vetëm anëtarët e BD.

BD i merr vendimet/rekomandimet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Bordit.

### **Dokumentimi i punës së BD**

Një listë e pjesëmarrësve dhe procesverbal përgatiten nga çdo takim.

Procesverbali përgatitet nga koordinatori për procedurat administrative ose në mungesë të tij me marrëveshje të ndonjërit prej anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e BD.

Procesverbali dërgohet për t'u konfirmuar nga ata anëtarë që ishin të pranishëm në mbledhje. Pas konfirmimit të procesverbalit, ai u dërgohet të gjithë anëtarëve të Platformës.

### **Aspektet teknike të punës së BD**

Pjesëmarrja e anëtarëve të BD është në baza vullnetare.

Në fund të çdo viti rishikohet puna e Platformës dhe mbi këtë bazë jepen propozimet për ndryshime apo pika shtesë të Rregullores së Punës. Nëse gjatë vitit konstatohet se ndonjë pikë e Rregullores së Punës është pengesë për funksionimin e BD dhe të Platformës, me kërkesë të së paku 3 anëtarëve të BD mund të rishikohet dhe ndryshohet me vendim të B.